

UDHËZIM
Nr. 689, datë 2.10.2018

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESJES
SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe në pikën 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”,

UDHËZOJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është:

- Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360 lekë.
- Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0–3 vjeç, të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 360 lekë.
- Për fëmijët e grup-moshës 4–5 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 400 lekë.
- Për fëmijët e grup-moshës 6–12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 440 lekë.
- Për fëmijët e grup-moshës 13–15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 480 lekë.
- Për fëmijët e grup-moshës 16–18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 500 lekë.
- Për përfituesit mbi moshën 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 520 lekë.
- Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7–11 vjeç, në 400 lekë.
- Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç, në 500 lekë.

2. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesjes shoqërore, është:

- Në qendrat ditore polivalente, në 230 lekë.
- Në qendrat ditore të zhvillimit, në 320 lekë.
- Në shtëpinë e fëmijës, në 320 lekë.

3. Niveli i kuotës financiare për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare të përballimit për shpenzimet e ushqimit nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qendror, të programuara për shërbimet e përkujdesjes shoqërore.

5. Udhëzimi nr. 5, datë 1.8.2012, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga data 1.10.2018.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

